

14.12.2021
Ora 13:10

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për kthimin për plotësim të kërkesës nr.1 të KSHZ “Për vendosje sanksioni administrativ, sipas vendimit nr. 467, datë 11.11.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.L.Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y.Merkaj, Z. E.Mema.
- **Të tjerë:** Z. Florian Pullazi, administrator i Njesisë
Administrative nr.2, Tiranë.

Z. E. Çefa: Përshëndetje, hapim seancën paraprake për shqyrtimin e propozimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të parashtruar në vendimin e tij nr.467, dt.11.11.2021, lidhur me marrjen e masave administrative, apo sanksionit administrativ kundrejt zotit Florian Pullazi, administrator i Njesisë Administrative nr.2 Tiranë. Shkelje kjo e konstatuar në të njëjtin vendim të Komisionerit. Sipas shortit të hedhur dje në datën 13.12.2021, relator i kësaj çështjeje jam unë, Elvis Çefa. Sot do të shqyrtojmë vetëm elementët formalë dhe do të marrim një vendim paraprak, në se do ta kalojmë çështjen në seancë shqyrtimi, apo jo. Nga pikëpamja procedurale, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, legjitimohet në shqyrtimin e kësaj kërkesë, pikërisht bazuar në nenin 21 të Kodit Zgjedhor. Po ashtu, Komisioneri, bazuar në Kodin Zgjedhor, por dhe me rregulloren e brendshme të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 14.12.2021

KAS, ka detyrimin t'i referojë dhe t'i kërkojë zyrtarisht KAS-it, marrjen e sanksioneve, duke bërë dhe propozimin e sanksionit përkatës. Ndërkohë që dhe çështja është lëndë patjetër e KAS-it. Shkurtimisht për të na relatuar pak për rrethanat e faktit, i jap fjalën përfaqësuesit të KQZ-së, Sekretarit të Përgjithshëm. Zoti Merkaj, fjala për ju!

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve, në datën 19.03.2021, është raportuar nga Organizata "Qëndresa Qytetare" denoncimi me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2368, ndaj kandidatëve për deputetë të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, zotit Alqi Bllako dhe zonjës Kledina Skëndo, për të cilët pretendohet se kanë shkelur neni 91, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimin nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Në provat e sjella nga Organizata "Qëndresa Qytetare" pretendohet se këta dy kandidatë për deputetë, kanë shfrytëzuar bibliotekat e qytetit të Tiranës. Fillimisht është kërkuar vetëm për Bibliotekën "Misto Treska", ndërsa në seancën e dytë është veçuar çështja e ankimit administrativ, duke pretenduar se janë bërë në dy biblioteka të ndryshme, "Misto Treska" dhe "Moikom Zeqo". Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, fillimisht me vendimin nr. 424, datë 12.07.2021, vendosi "Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit, për arsye se nuk konstatohen shkelje. Kundër këtij vendimi, Organizata "Qëndresa Qytetare", në datën 22.07.2021, ka paraqitur ankim, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve i cili, me vendimin nr. 107, datë 26.07.2021, vendosi: Shfuqizimin e vendimit nr. 424, datë 12.07.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe ka urdhëruar riçeljen e hetimit administrativ të plotë e të gjithanshëm nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në referim të urdhërimeve të KAS-it është riçelur hetimi administrativ, duke zhvilluar një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.12.2021*

seancë dëgjimore, në të cilën u thirrën palët në këtë hetim. Pala ankuese Organizata “Qëndresa Qytetare”, përfaqësuesi i Partisë Socialiste, kandidati për deputet zoti Alqi Bllako si dhe përfaqësuesi i Njesisë Administrative ku ndodhet Biblioteka “Moikom Zeqo”. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri ka konstatuar se..., janë konstatuar shkelje nga ana e administratorit të Njesisë Administrative nr.2, Tiranë. Në këto kushte ka vendosur konstatimin e shkeljes nga ana e zotit Florian Pullazi, dhe i ka kërkuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e sanksionit administrativ. Referuar nenit 21 pika “dh” e Kodit Zgjedhor, ku Komisioneri propozon për vendosjen e sanksioneve administrative, i jemi drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe brenda afatit 3 ditor, pasi kemi pritur afatin 30 ditor të ankimimi kundër këtij vendimi. Pas kalimit të këtij afati ja kemi paraqitur KAS-it për shqyrtim këtë kërkesë. Kërkesa plotëson të gjithë elementët e mëposhtëm, legjitimimin e KAS-it për të shqyrtuar këtë kërkesë. Ka kaluar afati 30 ditor për ankimimin, duke qenë se nuk ka pas ankimim, si dhe legjitimimin e ankuesit, faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit. Tani ne si KAS, sigurisht jemi të detyruar t’i shqyrtojmë në themel, nga pikëpamja formale, mënyrën e parashtrimit të kërkesës. Tani i referohemi nenit 19 të ligjit pra, Kodit Zgjedhor, kompetencës së Komisionerit. Nuk përcaktohet me detaje ndonjë mënyrë se si kjo kërkesë, apo se si Komisioneri vendos, vë në lëvizje KAS-in për sa i përket këtyre kërkesave të kësaj kategorie. Për shkak se është hera e parë që ne shqyrtojmë një çështje të kësaj natyre, mendoj që ia vlen të ndalojmë pak. Në mënyrë që të vendosim një standart për rastet e tjera. Unë shoh në fakt., kërkesa për të vënë në lëvizje KAS-in është me firmën e Sekretarit të Përgjithshëm. Të them të drejtën nuk e shoh krejtësisht në përputhje me nenin 19 të kodit dhe me nenin 35 të rregullores. E cila për më tepër parashikon që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.14.12.2021

“në kërkesën që Komisioneri i drejton KAS-it duhet të sugjerohet edhe niveli dhe lloji i sanksionit”. Psh gjobë në shumën “x” lekë, apo diçka tjetër. Gjë të cilën ne nuk e kemi përpara. Unë mendoj që me kolegët, mirë do të ishte që të fokusoheshim pak këtu në mënyrë që ta unifikojmë praktikën për herët e tjera, apo jo? Kush do të thotë diçka?

Z. I. Rusmali: Nqs mund të them unë diçka shumë shkurt. Të dy elementët, edhe forma edhe përmbajtia kanë një lloj rëndësi për KAS-in. Forma është e rëndësishme, sepse është akti që ve në lëvizje KAS-in. Ligji e përcakton që në rastin e sanksioneve KAS-i vihet në lëvizje jo me ankesë, por me kërkesë. Ndërkohë ne nuk kemi kërkesë nga pikëpamja formale të parashtruar. Siç mund ta lexojmë fare mirë, besoj se dhe Ylli do të jetë dakord me mua, pavarësisht se shkresës i është dhënë një objekt ku lexohet kërkesë, shkresa e Yllit është thjesht shkresë përcjellëse e vendimit, apo jo Ylli? Shkresa përcjellëse e vendimit nuk mund të trajtohet nga ana jonë si kërkesë. Ne nuk themi nëse.., besoj nuk kemi të drejtë të themi nëse Komisioneri duhet që procedurën e vet të hetimit duhet ta mbyllë formalisht me një vendim, apo mund të mos marrë vendim dhe të kalojë direkt në një kërkesë drejtuar KAS-it për vënien e sanksionesh? Sepse shprehje vullneti është dhe kërkesa, shprehje vullneti është dhe vendimi. Vendimi thjesht për shkak të afatit të ankimimit vonon dhe në raste zgjedhjesh do të bëhet problematik se vonon procedimin. Nga pikëpamja formale ne na duhet të vihem në lëvizje nga një kërkesë formale nga ana e Komisionerit. Tani Komisioneri mund të ketë.., ndoshta i bie në qafë unë, merakun se mund të mendojë se po paraqiti kërkesë duhet të vijë personalisht këtu. Nuk është e nevojshme të vijë personalisht këtu, por shkresa në formën e një kërkesë duhet të na vijë ne. Ai ka staf që autorizohet ta përfaqësojë dhe ne nuk jemi xhelozë për prezencën fizike të Komisionerit, por akti që na ve në lëvizje duhet të ketë formën juridike të një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.14.12.2021

kërkese, e para. E dyta, janë të domosdoshme elementët e përmbajtjes, sepse neni 35 i ka vënë taksativë për ne. Ju e dini ne nuk guxojmë kurrë t'ia bëjmë dysh fjalën Rregullatorit. Se kemi bërë asnjëherë e nuk kemi pse e bëjmë tani. Nqs Rregullatori i vendos aktit elementë taksativë të përmbajtjes, ne jemi të detyruar që ta kërkojmë me elementët taksativë të përmbajtjes. Ne na duhet që të paraqitet në këtë formë dhe na duhet se s'bën të na paraqitet propozimi. Si do të operojmë ne? Si do të operojë pala tjetër? Pala e prekur duhet të dijëse çfarë mendon Komisioneri? Cili duhet të jetë lloji i sanksionit dhe cila do të jetë masa e sanksionit? Këtë do të debatojmë këtu. A është lloji i propozuar i sanksionit i mbështetur në ligj? A është masa e propozuar e sanksionit në përputhje me..., proporcionale në raport me shkeljen? Nqs nuk kemi këto, ne nuk kemi se çfarë të diskutojmë, çfarë do të diskutojmë? Do të marrim në shqyrtim se si e ka bërë hetimin komisioneri? Nuk është ky objekti. Se si e ka bërë hetimin Komisioneri merret në shqyrtim në një procedurë ankimore, nuk e kemi në këtë lëndë, procedurën ankimore. Ne kemi kërkesën dhe kërkesa duhet të ketë të gjithë elementët përbërës të saj. Unë mendoj se ne jemi ende në seancë përgatitore dhe të gjithë këta elementë mund t'i kthehen administratës për korigjim dhe të sillen në formën e caktuar, këtë mendim kam unë. Nuk di çfarë mendimi keni ju.

Z. E. Çefa: Faleminderit zoti Rusmali! Po zoti Braho!

Z. L. Braho: Përveç se jam dakord me gjithë çfarë relatoi zoti Rusmali, unë kam një shqetësim tjetër që mendoj ta diskutojmë meqenëse është rasti i parë. Në lidhje me faktin që përveç kërkesës që ka paraqitur Sekretari i Përgjithshëm, kemi dhe një vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimmarrja që parashikon një afat 30-ditor ankimimi. Kjo deri diku na fut në një ngërç procedural se nqs rregulloria flet për kërkesë, nuk mund të ketë vendim-ankim. Pra, kërkesa është

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.12.2021*

kërkesë dhe është e paankimueshme, në këtë rast shërben si shkallë e parë ankimimi KAS-i dhe më tej gjykata. Besoj që këto vendimmarrje si kjo duhet të anashkalohen për mendimin tim. Të mos ketë më vendime, por vetëm kërkesa për këto raste në mënyrë që në rastin kur komisioneri nuk konstaton se ka shkelje atëherë merret vendim dhe pala ka të drejtë ankimi. Por në rastin që konstaton se ka shkelje nuk ka vend për vendim, por vetëm për kërkesë.

Z. K. Bele: Mund të kristalizohet, por ndoshta Komisioneri në atë vendim, në një rast tjetër, siç ka bërë në këtë rast se janë disa palë në një shqyrtim administrativ. Pra për dikë vendos pushimin për një tjetër vazhdimin duke konkluduar me dërgimin... Mbase forma e vendimit do të ishte korniza e duhur për ta mbyllur, pastaj vendimit i bashkëlidhet kërkesa për... Ai duhet të disponojë mendoj unë për aktin, a mund të ishte kërkesa një formë që kënaq vendimin siç thotë Iliri, nëse është ky rast dakord. Por një moment deklarativ të përfundimit të procesit për mendimin tim ai duhet ta shfaqë. Ndoshta kjo mund të rregullohet me një akt të Rregullatorit më vonë i cili mund të bënte dhe një lloj formatimi të këtyre mbase të tilla mund të këtë të shpeshta por, jam edhe unë i paqartë.

Z. L. Braho: Sepse rasti është i tillë ,sepse unë nuk e di nëse zoti Pullazi ka bërë ankim, apo ndonjë nga palët ka bërë ankim por nqs kalon afati 30-ditor dhe zoti Pullazi nuk ka bërë ankim do të thotë që ai ka pranuar këtë vendimmarrjen në lidhje me rezultatin e Komisionerit apo palët e tjera? Pra, këtë vendim konstatimin që ka kryer shkelje, fajësim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.14.12.2021

Z. K. Bele: Ndoshta do bënte ankim ndaj çfarë? Ndaj asaj që shiheni a ka probleme? Se ai nuk ka disponuar që të thotë... është kjo pra, është shkelja e këtij neni në raport me këtë sanksion, sepse...

Z. I. Rusmali: Jo, ai ndoshta mund të kishte bërë ankim për procesin e rregullt, sipas asaj që dëgjova unë pak më parë, sigurisht që ai nuk e bën dot më tani atë ankim sepse ka ikur. Meqënëse jemi në këtë lloj diskutimi gati informal në këtë pikë, është thirrur për të marrë pjesë në këtë proces, por praktikisht është thirrur në momentin e shpalljes së vendimit. Pra, nuk ka kontribut tek hetimi, apo jo? Është kështu? Kjo i jep një difekt që ne nuk e shqyrtojmë dot më tani. Ndoshta i takon siç thotë zoti Bele, që ai hetimin e mbyll me vendim. Por pjesë e vendimit nuk mund të jetë diskutimi i sanksionit, sepse sanksioni është kompetencë primare e KAS-it. Në KAS duhet të vijë me kërkesë jo me vendim dhe në kërkesë duhet të plotësojë të gjithë elementët përbërës të kërkesës siç ja kërkon neni 35. Më e rëndësishmja prej tyre që mungon..., ne s'kemi vullnet të shprehur. Ne vullnetin e shprehur të Komisionerit nuk e marrim dot nga Ylli sot, edhe sikur të thotë që "e di unë se ç'mendon Komisioneri" për ne nuk ka vlerë. Ndërkohë që ne kemi nevojë të dimë gjykimin e Komisionerit për llojin dhe masën e sanksionit administrativ që ai i propozon KAS-it. KAS-i ka vetëm këtë lëndë, diskutimin rreth sanksionit, në këtë pikë. Nuk ka diskutimin rreth hetimit, sepse diskutimi rreth hetimit do të bëhet më procedurë ankimore, hetim i mirë i saktë, i plotë, i paplotë e me rradhë. Ndërkohë që kur ka kërkesë, kërkesa diskutohet vetëm sanksioni, logjika dhe proporcionaliteti i tij. Këtë duhet të diskutonim sot, por ne duhet ta kemi përpara propozimin që ta diskutojmë.

Z. E. Lako: Unë jam me Ledion për sa i përket mënyrës se si e ka trajtuar Komisioneri, ai nuk duhej të shprehej me vendim. Kjo është vendimmarje e KAS-it,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.12.2021*

nuk është e Komisionerit. Komisioneri thjesht duhet të bëntë hetimin, duhet të bënte procedurën dhe duhet të vinte me një kërkesë këtu pranë KAS-it. KAS duhet të vendoste pastaj me vendim që a ka fajësi dhe masën e fajësisë. Nuk mund të vijë këtu një gjë që është gjykuar dhe çfarë të na lihet ne? Na lihet vendosja e sanksionit në bazë të shkeljes së pretenduar? Nuk ka kuptim, kjo që tha dhe Ledio, nuk ka kuptim vendimmarrja që i takon KAS-it në një fazë të parakohshme dhe me një ankim. Për mua është komplet një procedurë gabim që na çon pastaj në një kolaps për sa u përket dhe ankimeve dhe procedurës se si do të vazhdojë. Dmth ka të bëjë me përgjegjësinë, me masën e përgjegjësisë, me kompetencën.

Z. E. Çefa: Faleminderit, besoj se është e qartë tashmë, kështu që ne duhet të marrim një vendim. Dakord atëherë, KAS i konsultuar në vend, duke konsideruar që procedura e ndjekur deri tani nuk është ajo e specifikuar në nenin 35 të rregullores, unanimisht vendos:

Kthimin e akteve Komisionerit për plotësim dhe për korrigjim sipas kriterëve dhe procedurës të përcaktuar në nenin 19 të Kodit Zgjedhor dhe në nenin 35 të Rregullores së Funkcionit të Komisionit Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Më pas ne do të kemi mundësinë të shprehemi me një vendim për themelin e kësaj çështjeje. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 114

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

